



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:031264
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05620003

C-IV.-14-3228

Paditësi: B K fsh.D e K, Vushtrri.
Përfaqësuar nga H K, fsh.D e K, Vushtrri.

Kundër

Agjencisë Kosovare e Privatizimit,(AKP) Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren Ganimete Puka, me datë 25.04.2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimet e Autoritetit të Likuidimit PRN046-1018, të datës 24 mars 2014, dhe PRN046-1019, të dt. 24.03.2014, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.
- II. **Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 28 prill 2014, paditësja në emër të bashkëshortit të saj, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankese lidhur me Vendimet nr. PRN046-1018, të datës 25 mars 2014, dhe PRN046-1019, të dt. 24.03.2014 të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) më të cilin ka kërkuar, që të këtë parasysh dhe të shqyrtoj edhe njëherë vendimet e AL-së me numra të lartcekura me të cilin i është refuzuar kërkesa për pagat e papaguara ne shumen prej 1,217.07euro, nga NSH. FAN “Zahir Pjaziti” ne likuidim Podujeve, ne te cilën ndërmarrje kishte punuar bashkëshorti i saj, i cili kishte ndërruar jete, dhe pretendon se kjo nuk ishte e njoftuar se NSH kishte hyre ne proces te likuidimit, e cila ndërmarrje është privatizuar me 23.03.2006, si dhe kërkon qe kjo shkrese e saj te merret shume serioze duke theksuar se kushtet materiale i ka shume te renda. Ankesës i ka bashkangjitur si provë dy vendimit e AL, si kopjes e letërnjoftimin e vet dhe te bashkëshortit të saj.

Më datë 05 mars 2024, Gjykata i ka dërguar urdhër paditëses përmes të cilit ka kërkuar që të sjell prova relevante shtese lidhur me pagat e papaguara pasi që ne ankesën e saj dorëzuar kësaj gjykata nuk ka bashkangjitur asnjë prove te vetme. Mirëpo, pas kësaj gjykata nuk ka marre asnjë përgjigje nga ankuesja.

Me datë 24 prill 2024, urdhri me nr.C-IV-14-3228 i dt. 05.03.2024 është publikuar ne tabelën e shpalljes, pas dështimit të dorëzimit- pranimit të dokumentit në baze te nenit 26 par 5 të Ligjit nr.06/L-086 për 3-283621 Dhomën e Posaçme, nenit 116.5 dh 116.6 të LPK, dhe i njëjti ka qëndroi ne tabelën e shpalljeve nga dt.12.04.2024 deri me dt.23.04.2024.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata ka shqyrtuar të gjitha shkresat që gjenden në dosje të lëndës dhe pretendimet e palëve dhe ka konstatuar se kërkesa e ankueses është e pa bazuar dhe se nuk është e mbështetur në fakte dhe prova relevante, pasi që ankuesja ka paraqitur vetëm një ankese të shkruar me dore kundër vendimeve të AL-së me numër PRN046-1018, të datës 25 mars 2014, dhe PRN046-1019, të dt.

24.03.2014, për paga të papaguara dhe nuk ka dorëzuar asnjë prove të vetme për të mbështetur ankesës së saj.

E paditura në vendimin e saj Nr. PRN046-1018, dhe nr.PRN046-1019, me të cilën ka refuzuar kërkesën e ankuesit në pjesën arsyetuese kur i është referuara nenit 35.5 të shtojcës së ligjit të AKP-së, ka arsyetuar se *“AL-ja mund te pranoje një kërkesë pas afatit për parashtrimin e kërkesave vetëm nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindes për parashtrim të vonuar”*, gjë që ankuesi nuk e ka bërë, nuk ka ofruar arsye te justifikueshme për parashtrim të vonuar.

Gjykata vëren se ankuesja kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara, në shumë prej 1,217,07 €, nuk e ka mbështetur me prova para AL prandaj vendimi i AL konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Ankuesja edhe me ankesën para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH. *“AN ‘Zahir Pjazit’ ne likuidim Podujeve”*, i ka mbetur borxh pagat e kërkuara.

Në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi ka paguar taksës gjyqësore për padi.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka